



## Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë Prezenca e OSBE-së në Shqipëri

Fjalim nga  
Ambasadori Osmo Lipponen, Kryetari i Prezencës  
Konferencë për Shtyp, 18 nëntor 2003

Unë nisem sot në Vjenë për të paraqitur raportin gjashtëmujor të radhës në Këshillin e Përhershëm të OSBE-së mbi zhvillimet më të fundit në vend dhe aktivitetet e Prezencës në lidhje me to, si dhe për veprimtaritë e saj në vitin pasardhës. Megjithë debatin intensiv të provokuar nga raporti ynë i fundit, i mbajtur në qershor, ka patur vazhdimisht një mbështetje të fortë për rolin e Prezencës. Ajo ka vepruar si një moderatore e rëndësishme për dy çështje kryesore, që mbartin një rëndësi politike të veçantë, që janë reforma zgjedhore dhe kthimi dhe kompensimi i pronave. Në të njëjtën kohë, Prezenca ka vazhduar punën e saj në mbështetje të shtetit ligjor dhe demokratizimit.

Megjithë tensionet politike rreth zgjedhjeve, që janë shfaqur gjatë kësaj periudhe, pritja e mirë e projektligjit për pronat tregon se ka ende mundësi për të arritur marrëveshje për çështje themelore. Megjithatë, Prezenca është e shqetësuar se preokupacionet aktuale po e vënë në rrezik, midis të tjerave, Procesin e Stabilizim Asociimit, siç është vërejtur së fundi edhe nga Bashkimi Evropian.

Arritjet e bëra në procesin e reformës zgjedhore dhe vullneti rëndësishëm politik i përmirësuar për të zhvilluar zgjedhje të lira, të ndershme dhe demokratike kontribuan në mënyrë të konsiderueshme në një lloj fushate shumë të ndryshme, një fushatë, në të cilën kandidatët në të gjithë vendin trajtuan çështje që ndikojnë në jetën e përditshme të njëri-zve. Kodi i ri zgjedhor trajtoi pjesën më të madhe të rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it dhe ka kontribuar në një rol më pozitiv të policisë dhe medias. Megjithatë, periudha pas zgjedhore ka treguar përsëri natyrën e tejzgjatur dhe konfliktuale të zgjedhjeve në Shqipëri, në veçanti vonesat e ndeshura në shpalljen e rezultateve për Tiranën. Prezenca ka studiuar në mënyrë aktive problemin e listave të zgjedhësve dhe së bashku me ODIHR-in, është duke analizuar mënyrat për trajtimin e mangësive.

Në vazhdim të suksesit të reformës zgjedhore në vitin 2003, do të debatohen elementë të mëtejshëm të reformës, në mënyrë të veçantë mundësia e ndryshimit të sistemit zgjedhor, financimi i fushatës dhe rikonfigurimi i kufijve të zonave zgjedhore. Çështja e reformës për ndarjen territoriale administrative do të vazhdojë gjithashtu vitin tjetër. Duke marrë parasysh implikacionet e qarta politike të një procesi të tillë sfidues, që kërkon transparencë dhe ndershmëri, Prezenca është ftuar të luajë një rol kyç në këtë proces shumëvjeçar si nga Ministria e Pushtetit Vendor dhe nga lideri i opozitës.

Çështja e kthimit dhe kompensimit të pronave, në qoftë se zgjidhet deri në fund të vitit 2003 nëpërmjet adaptimit të një ligji të ri, do të kërkojë angazhimin e Prezencës që të ndihmojë për të siguruar një zbatim korrekt të ligjit, të paktën në fazat e tij

fillestare. Megjithatë, reforma e mëtejshme në sektorin ligjor është themelore për të mbështetur pjesën më të madhe të proceseve të reformave të vazhdueshme. Një shqetësim kryesor për Prezencën është nevoja gjithëpërfshirëse për një transparencë më të madhe për të ulur padrejtësitë dhe arbitraritetin e sistemit gjyqësor që vjen nga pasojat korruptive të abuzimit të influencës dhe konflikteve të interesave.

Pavarësisht nga shenjat relativisht pozitive të zhvillimit në strukturën e përgjithshme institucionale të vendit dhe forcimit të elementeve themelore, vendi vuan nga dobësia e vazhdueshme në fushën e çështjeve të drejtësisë dhe të brendshme, në veçanti përsa i përket mjeteve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar. Ndërsa qeveria ka filluar të ndërmarrë hapa aktiv dhe strategji të gjithanshme në këtë fushë, zbatimi i tyre, siç është vërejtur në mënyrë të përsëritur, është i ngadaltë dhe vuan nga mungesa e prioriteteve.

Prezenca është duke zbatuar një numër programesh për të ndihmuar në këto fusha. Projekt buxheti i Prezencës për vitin 2004 përcakton prioritetet e saj për vitin tjetër, duke u përqëndruar në çuarjen më tej të procesit të reformave dhe forcimit të institucioneve demokratike.